

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Maj 2026

www.cp-project.al info@cp-project.al



Seminar mbi Platformën HELP4U për Forcimin e Mbrojtjes së Fëmijëve

Më 14-15 maj 2026, Drejtorja e Hetimit të Krimin Kibernetik, në Policinë e Shtetit, e mbështetur nga Programi SCPA dhe në bashkëpunim me Europolin, organizoi seminarin mbi Platformën **HELP4U** në DPPSH, në kuadër të iniciativës EMPACT OAP 2026-27 për luftën kundër krimeve me rritjen më të shpejtë në hapësirën digjitale.

Ky seminar mbledhi së bashku përfaqësues nga autoritetet e zbatimit të ligjit, linjat telefonike, linjat e ndihmës, organizatat e mbrojtjes së fëmijëve, ekspertë, partnerë të projektit nga Shqipëria, oficerë të sigurisë në shkollë, punonjës socialë, psikologë dhe oficerë të policimit në komunitet që punojnë me të rinjtë në shkolla si edhe ekspertë të **EUROPOL** dhe **CENTRIC**.

Gjatë aktivitetit dy-ditor, pjesëmarrësit diskutuan zhvillimin dhe zbatimin e ardhshëm të platformës HELP4U, që synon ofrimin e mbështetjes dhe informacionit të personalizuar për viktimat e dëmit të shkaktuar online.

Agjenda përfshinte prezantime mbi vizionin e projektit, demonstrimin e platformës, diskutime mbi paketat e

punës së projektit dhe ndërveprim të fokusuar në forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në mjedisin digjital.

Seminari shërbeu gjithashtu si një mundësi për krijimin e rrjetëve, shkëmbimin e ekspertizës dhe forcimin e partneriteteve midis institucioneve dhe organizatave që punojnë për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet dhe shfrytëzimi në internet.



AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Seminar mbi Platformën HELP4U për Forcimin e Mbrojtjes së Fëmijëve
- ◆ Drejtuesi i EMP të Programit SCPA takon Drejtorin e Përgjithshëm të PSH
- ◆ Aktivitete nga Skema e Granteve – për Dhunën në Familje
- ◆ Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtorja Vendore e Policisë Shkodër
- ◆ Aktivitete nga Skema e Granteve për sigurinë e të rinjve dhe sigurinë rrugore
- ◆ Aktivitete mbështetur nga skema e granteve për forcimin e MKR-ve
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuere në shkolla




Drejtuesi EMP të Programit SCPA takon Drejtorin e Përgjithshëm të PSH

Me datë **14 Maj 2026**, Zoti **Ansi Shundi**, drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit për Forcimin e Policimit në Komunitet (SCPA), takoi Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, **Drejtues Madhor Skënder Hita**.

Gjatë takimit, Drejtori Përgjithshëm Z. Hita vlerësoi bashkëpunimin me SCPA si dhe mbështetjen e dhënë për Policinë e Rendit, Policinë Rrugore dhe Akademinë e Sigurisë.

Ai theksoi se partneriteti pa barriera dhe i ndërtuar mbi besim të ndërsjellë, ka dhënë rezultate në fushat me impakt të lartë publik si Policimi në Komunitet.

Ndërkaq, Zoti Shundi theksoi angazhimin e plotë të EMP, për ta mbështetur më tej PSH në rrugën drejt modernizimit dhe përmbushjes së standardeve evropiane për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë së kohës.

**Aktivite nga Skema e Granteve – për Dhunën në Familje**

Gjatë muajit maj 2026 u zhvilluan disa aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese në kuadër të Programit SCPA – Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri, me fokus parandalimin e dhunës dhe promovimin e marrëdhënieve të shëndetshme:

- **4 maj 2026, Tiranë** – Në gjimnazin “Asim Vokshi”, Qendra IZHS organizoi një sesion mbi parandalimin e dhunës dhe rëndësinë e raportimit të hershëm. Diskutimet përfshinë dhunën në familje, bullizmin, dhunën digjitale dhe sigurinë online. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Vendimmarrja që Mbron – Forcimi i reagimit policor dhe standardit profesional në trajtimin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore”, pjesë e Skemës së Granteve të Programit SCPA.
- **14 maj 2026 Elbasan** – Organizata “Tjetër Vizion” prezantoi platformën “Raporto Tani” në shkollën e mesme “Vasil Kamami”. Nxënësit e vitit të parë shprehën interes për përdorimin e aplikacionit si mjet i sigurt për raportimin e dhunës, bullizmit dhe diskriminimit.
- **22 Maj 2026 Takim institucional** – Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri” (SEH) dhe Bashkia Tiranë zhvilluan një takim me ETN-në dhe institucionet lokale mbi menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, duke prezantuar risitë e Ligjit Nr. 11/2026. Pjesëmarrësit diskutuan mbi risitë e Ligjit Nr. 11/2026 “Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje”, përfshirë ndalimin e ndërmjetësimit, detyrimin për raportim, format e reja të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhuna digjitale dhe ngacmimi në hapësirat publike.
- **25 maj 2026 Tiranë** – Në shkollën 9-vjeçare “Kosova”, IZHS zhvilloi një tjetër sesion ndërgjegjësues mbi format e dhunës dhe mekanizmat e raportimit, duke nxitur reflektim mbi reagimin në kohë.
- * **26 maj 2026 Tiranë** – Nxënësit e gjimnazit “Abdulla Keta” morën pjesë në një sesion interaktiv mbi policimin në komunitet, marrëdhëniet e shëndetshme dhe sigurinë digjitale, duke reflektuar mbi rolin e tyre në krijimin e një komuniteti mbështetës. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Vendimmarrja që Mbron – Forcimi i reagimit policor dhe standardit profesional në trajtimin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore”, pjesë e Skemës së Granteve të Programit SCPA.

Aktivite nga Skema e Granteve për sigurinë e të rinjve dhe sigurinë rrugore



Gjatë muajit maj u zhvilluan aktivitete për sigurinë e të rinjve në Kukës, Tropojë, Fier, Elbasan, Maliq dhe Tiranë për rritjen e sigurisë së të rinjve, sigurinë rrugore, parandalimin e bullizmit dhe dhunës digjitale, si dhe forcimin e bashkëpunimit mes shkollës, familjes, policisë dhe komunitetit.

10 Maj 2026 – Kukës-Qendra për Progres Rinor (QPR) organizoi një seancë informative në shkollën “Qazim Shehu”, Shtiqën. Nxënësit dhe mësuesit u angazhuan në aktivitete interaktive mbi bullizmin, sigurinë digjitale dhe raportimin e hershëm të rasteve problematike. Aktivitetet “Vija e Debatit” dhe “Rrethi i Privatësisë” ndihmuan të rinjtë të kuptojnë sjelljet online dhe kufijtë e sigurisë së të dhënave.

12 Maj 2026 – Maliq. Shoqata “Unë, Gruaja” zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues në gjimnazin “Skënderbeu” mbi sigurinë kibernetike dhe dhunën digjitale. Nxënësit, stafi pedagogjik dhe policia vendore diskutuan mbi bullizmin online, mbrojtjen e të dhënave personale dhe rëndësinë e raportimit.

19 Maj 2026 – Tiranë Shoqata “Unë, Gruaja” zhvilloi një takim informues me studentët e vitit të parë të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane. Diskutimet u fokusuan mbi dhunën digjitale, pasojat e saj psikologjike e sociale, si dhe shërbimet

ligjore dhe mbrojtëse në dispozicion të viktimave.

Maj 2026 – Tropojë-Shoqata “Alpin” organizoi një workshop me Policinë e Tropojës dhe Njësinë Administrative. Diskutimet u përqendruan në bullizmin shkollor e kibernetik, sigurinë rrugore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për mbrojtjen e të rinjve.

Maj 2026 – Fier-Qendra “Epoka e Re” në bashkëpunim me institucionet vendore zhvilloi një aktivitet informues në shkollën “Dertliu”. Të rinjtë u ndërgjegjësuan mbi konfliktet me ligjin, parandalimin e fenomeneve negative dhe rolin e institucioneve në mbështetjen e komunitetit.

Maj 2026 – Tiranë Shoqata “Atletët Veteranë të Shqipërisë” realizoi aktivitete sportive dhe ndërgjegjësuese në shkollat “Osman Myderizi” dhe “Kristaq Rama”. Rreth 120 nxënës morën pjesë në sesione mbi parandalimin e dhunës, menaxhimin paqësor të konflikteve, sigurinë online dhe rolin e Policisë së Shtetit në mbrojtjen e të rinjve.

Nga data **4 maj 2026**, Kuratoriumi për Sigurinë Rrugore (KRS) zhvilloi një seri prej **5 seancash trajnuese** me maturantët e Gjimnazit “Myslym Keta” në Tiranë. Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi rreziqet në rrugë, normat e sjelljes dhe respektimin e rregullave të qarkullimit.

•Nxënësit u njohën me shkaqet

kryesore të aksidenteve: shpejtësia, përdorimi i alkoolit, mungesa e përvojës dhe mosvendosja e rripit të sigurimit.

- U trajtuan penalitetet ligjore për drejtimin pa leje dhe pasojat e sjelljes së papërgjegjshme.
- Një temë qendrore ishte **përdorimi i rripit të sigurimit**, i ilustruar me shembuj konkretë dhe demonstrime mbi efektet e ligjit të inercisë.
- Përmes **simulatorit të rripit të sigurimit**, maturantët provuan rrokullisjen e një automjeti 360° dhe panë nga afër se si rripi mban trupin të fiksuar, duke ulur ndjeshëm rrezikun e lëndimeve.
- 22 maj 2026** – Aktivitet ndërgjegjësues në Sheshin Nënë Tereza KRS organizoi një tjetër aktivitet edukues, në bashkëpunim me Programin **SCPA**, i mbështetur nga Skema e Granteve.

- Pjesëmarrësit përjetuan përvoja praktike dhe ndërvepruese, si rrokullisja e simulatorit dhe pista e aktivitetit.
- Çdo element u konceptua për të ndihmuar të rinjtë të kuptojnë pasojat e sjelljes së pasigurt përpara se t’i hasin në realitet. Këto iniciativa tregojnë angazhimin e KRS për të edukuar brezin e ri mbi rëndësinë e sjelljes së përgjegjshme në rrugë dhe respektimin e rregullave të qarkullimit

Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe personelit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – DVP Shkodër



Në datat **05-07 maj, 13-15 maj dhe 20-22 maj 2026**, 3 grupe të përberë nga **Oficerë të Patrullës së Përgjithshme** dhe personel të **Sallës së Komandës dhe Kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër** morën pjesë në një trajnim të organizuar nga **Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA**, i zhvilluar në ambientet e DVP Shkodër. Numri i pjesëmarrësve ishte në total 73 Punonjës policie.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u njohën si me pjesën teorike ashtu edhe me ushtrimet praktike dhe me punën në grup, duke u fokusuar në filozofinë e Policimit në Komunitet dhe

zbatimin e elementeve të saj në punën e përditshme të oficerëve të Policisë së Shtetit.


Gjithashtu, atyre iu prezantuan situata/ushtime praktike për t'u trajtuar dhe zgjidhur prej tyre teksa punuan në grup me synimin për të siguruar masat që duhen marrë në mënyrë proaktive për zbatimin e elementeve të Policimit në Komunitet.

Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve të Dhunës në Familje si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik. Me qëllim për të

ofruar module trajnimi gjithëpërfshirëse, ekipi i Programit SCPA bashkëpunoi me **Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**, ekspertët e së cilës ofruan leksione ndërvepruese mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Praktikat më të mira të BE-së për zbatimin e filozofisë së PK u ndanë e shkëmbyen me oficerët e PSH. Në përfundim të këtij trajnimi, oficerët e PSH arrijnë të përmirësojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin e Policimit në Komunitet. oficerëve të Policisë së Shtetit,

Aktivite mbeshtetur nga skema e granteve për forcimin e MKR-ve



Në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Barazisë Gjinore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe me mbështetjen e Programit SCPA, më **13 maj 2026** u zhvillua në Fier "Takimi i rrjetit të anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit" për bashkitë Fier, Lushnjë, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër. Takimi bashkoi përfaqësues të

institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës, duke krijuar hapësirë për njohjen me ndryshimet ligjore të Ligjit Nr. 11/2026 "Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje", shkëmbimin e praktikave të mira dhe diskutimin mbi rolin e policimit në komunitet në mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarve. Gjithashtu, më **5 maj 2026**, në Bashkinë Malësi e Madhe u zhvillua takimi i MKR-së për trajtimin

e një rasti të një të miture në situatë rreziku. Me pjesëmarrjen e institucioneve vendore dhe organizatës "Gruaja tek Gruaja", në kuadër të Programit SCPA, u ofrua ekspertizë teknike dhe ligjore për garantimin e mbrojtjes së fëmijës. Pas vlerësimit të përbashkët të rastit, institucionet dakordësuan masat mbrojtëse për të miturën, përfshirë procedurat për Urdhër Mbrojtjeje dhe sigurimin e akomodimit të përshtatshëm.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, "Për zbatimin e Programit 'Siguria e të Rinjve' në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike," Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Maj 2026**.

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatorët vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit maj, fokusi i veçantë ka qenë te temat

e ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore te cilat përbëjnë prioritet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisaritet e qyteteve **Tiranë, Berat, Korçë, Pogradec, Kurbin, Fier, Lushnje, Durrës, Shkodër, Lezhë, Gjirokastrë, Kukës, Vlorë dhe Sarandë,**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **349** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë interaktive nga **4580** përdorues, duke

dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **71** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përsëritëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

